



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 20.11.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

PËR

**SHQYRTIMIN NË PARIM TË PROJEKTLIGJIT “PËR DISA NDRYSHIME NË
LIGJIN NR.9920, DATË 19.5.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR.**

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet datave 6.11.2018; 8.11.2018 dhe 20.11.2018, mori në shqyrtim në parim, projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bazuar në nenet 32-38 dhe 78-84 të Rregullores së Kuvendit.

Ky projektligj është pjesë e Paketës Fiskale së bashku me projektligjet e tjera financiare që shoqërojnë projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2019”.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Z. Ervin Bushati.

Në mbledhjet e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin të pranishëm Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe përfaqësues të tjerë të lartë të kësaj ministrie.

II. Baza ligjore Kushtetuese.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në nenet 78, 83 pika 1 , 113 pika 1 shkronja “ç”, 155 dhe 157 pika 3, të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit.

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka si objektiv kryesor thjeshtimin e procedurave tatimore, rregullimin e mangësive të evidentuara gjatë implementimit që çojnë në shmangien nga pagesat e duhura dhe evazion, mundësimin e përdorimit të mënyrave alternative të vlerësimit tatimor si dhe reduktimin e kostove të administrimit dhe të biznesit.

Në mënyrë më të detajuar parashikimet e këtij projektligji konsistojnë për sa më poshtë vijon:

- Në nenin 1 dhe 2, parashikohet ndryshimi i neneve 40 dhe 43 të ligjit ekzistues, duke mundësuar përmirësimin e rregullave të regjistrimit dhe pajisjes me NIPT/NUIS të tatimpaguesve, me qëllim deklarimin e saktë të të ardhurave të realizuara dhe shmangien e evazionit. Në këtë frymë, personi fizik mund të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me të njëjtin numër të identifikimit personal, vetëm një herë dhe do të mund të regjistrohet e pajiset me një NIPT/NUIS të ri, vetëm mbas çregjistrimit të atij ekzistues. Gjithashtu, për çdo veprimtari të re që kërkon të regjistrojë, personi fizik tregtar, do pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, për të mundësuar identifikimin e vendndodhjes të kësaj veprimtarie të re
- Në nenin 3, parashikohen rregullime dhe shtesa në nenin 44 të ligjit, lidhur me kalimin e tatimpaguesit në regjistrin pasiv, vetëm pas pagimit të të gjitha detyrimeve tatimore të tatimpaguesit. Ky përcaktim së bashku me përcaktimet e nenit 1 dhe 2 do të mbyllë shtegun për kalimin në regjistrin pasiv të një aktiviteti sa herë që evidentohet detyrime tatimore të papaguara duke mos lejuar shtimin e nivelit të borxhit të pambledhshëm. Çdo transaksion që do të kryhet nga tatimpaguesit e regjistruar në regjistrin pasiv do të konsiderohet si shkelje dhe do penalizohet së bashku me tatimpaguesin në regjistrin aktiv që ka kryen transaksionin me të.
- Në nenin 4, parashikohet ndryshimi tërësor i nenit 45, duke përcaktuar në mënyrë të detajuar procedurat lidhur me çregjistrimin e subjekteve tatimore, pranë QKB-së dhe Administratës Tatimore si dhe përcakton detajet lidhur me përcaktimin e datës së çregjistrimit për kategori të ndryshme tatimpaguesish, radhën dhe procedurën e çregjistrimit, afatet e veprimit dhe kushtet specifike për regjistrim.

- Në nenin 5 të projektligjit, parashikohet rritja e nivelit nga 100 (një qind) lekë në 1000 (një mijë) lekë të shumës së detyrimit tatimor të detyrueshme për t'u paguar ose e tepricës së kredisë, që vlerësohet si detyrim ose kredi me vlerë zero, shumë kjo për cilën nuk bëhet vlerësim tatimor nga administrata tatimore.
- Në nenet 6 dhe 7 të projektligjit, parashikohet e drejta e Administratës Tatimore për të përdorur mënyra alternative vlerësimi për rastet kur tatimpaguesi, person fizik, për qëllime të shmangies ose minimizimit të pagesave, mban më shumë se një NIPT/NUIS apo në rastet kur tatimpaguesit kryejnë një ose disa veprime/transaksione direkte apo indirekte që deformojnë parimet e ligjit tatimor; nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut, kur veprimi/transaksioni nuk reflekton thelbin e tij ekonomik apo evidentohen veprime/transaksione që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore.
- Në nenin 8, parashikohet shtimi i një pike në nenin 75 të ligjit bazë, duke krijuar lehtësi të tjera për tatimpaguesit dhe duke mundësuar kompensimin nga teprica kreditore të detyrimeve tatimore brenda çdo tatimi, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, automatikisht nga sistemi informatik.
- Në nenet 9, 10 dhe 11, përcaktohet radha e pagesës së kontributeve dhe të detyrimeve tatimore duke filluar me detyrimet më të hershme brenda të njëjtit lloj si dhe mundësohet lehtësimi i procedurave, përmes përdorimit të gjerë të komunikimit elektronik si dhe thjeshtësimit dhe qartësimit të procedurave të njoftimit për pagesën e detyrimeve tatimore, të pagesës.
- Në nenin 12 të projektligjit, propozohen ndryshime lidhur me procedurat e deklarimit të detyrimit tatimor si të pa mbledhshëm dhe fshirjen/shuarjen e tij ndërsa në nenin 13 vijohet me lehtësirat ndaj tatimpaguesit duke përjashtuar nga pagesa që duhen bërë si kusht për të ushtruar të drejtën e ankimit pranë organit tatimor, gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar dhe kamatë vonesat e llogaritura.
- Përmirësime dhe saktësime parashikohen edhe në kreun e sanksioneve, sipas neneve 14 deri 17 të projektligjit, përmes të cilave trajtohen si deklarim i pasaktë, rastet e rivlerësim në ulje të tepricës kreditore të tatimpaguesit, në përfundim të kontrollit tatimor, duke parashikuar një penalitet në masën 20% të diferencës ndërmjet tepricës kreditore të deklaruar me tepricën kreditore që duhej deklaruar si dhe propozohen lehtësira edhe në trajtimin e kundërvajtjeve administrative duke parashikuar ulje të penalteteve në 30%, për rastet kur tatimpaguesi pranon vlerësimin tatimor dhe e paguan detyrimin.

IV. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij, bëri një prezantim të detajuar të gjithë risive dhe parashikimeve konkrete që sjell projektligji, siç më sipër kemi evidentuar. Ai evidentoi dhe vlerësoi impaktin pozitiv që ky projektligj sjell, lidhur me thjeshtimin e procedurave tatimore duke bërë kështu një hap akoma dhe më cilësor në frymën e gjithë reformës së Qeverisë Shqiptare me fokus lehtësimin e biznesit dhe bashkëpunimin me të si dhe reduktimin e kostove

të administrimit dhe të biznesit. Relatori theksoi se ndryshimet e sjella, do të ndikojnë pozitivisht edhe në uljen e nivelit të shmangies nga pagesat që tatimpaguesi duhet të paguajë ndaj shtetit, mundësimin e përdorimit të mënyrave alternative të vlerësimit tatimor dhe përdorimin akoma më tej të teknikave informatike të përdorimit dhe përpunimit të informacionit.

Në përfundim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke vlerësuar se ndryshimet e propozuara në këtë projektligj mundësojnë thjeshtimin e procedurave tatimore në zbatimin e legjislacionit tatimore si dhe lehtësira të mëtejshme ndaj tatimpaguesve, e miratoi në parim projektligjin, me votat pro të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

RELATOR

Ervin BUSHATI

KRYETAR

Erjon BRAÇE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë më 27.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9920, DATË
19.5.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR
(shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi)**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 26 dhe 27 nëntor 2017, shqyrtoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Projektligji është pjesë e paketës së projektligjeve financiare që shoqërojnë projektbuxhetin 2019.

Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi u zhvillua pas miratimit në parim të këtij projektligji në seancën plenare të datës 22 nëntor 2017. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrtoi këtë projektligj bazuar në nenet 32-38 si dhe nenet 80 dhe 83 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e Komisionit të datës 26 nëntor ishin të pranishëm përfaqësues nga shoqatat e biznesit si Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Dhoma Amerikane e Tregtisë, Dhoma Italiane e Tregtisë në Shqipëri, Dhoma Gjermane e Tregtisë dhe Industrisë në Shqipëri dhe Biznes Albania. Ndërsa, në mbledhjen e datës 27 nëntor ishin të pranishëm Ministri i Financave dhe përfaqësues të tjerë të lartë të kësaj ministrie.

Ndryshimet dhe shtesat e propozuara nga Këshilli i Ministrave në legjislacionin e procedurave tatimore, konsistojnë:

- Përmirësimin e rregullave të regjistrimit dhe pajisjes me NIPT/NUIS të tatimpaguesve, me qëllim deklarimin e saktë të të ardhurave të realizuara dhe shmangien e evazionit. Në këtë frymë, personi fizik mund të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit,

me të njëjtin numër të identifikimit personal, vetëm një herë dhe do të mund të regjistrohet e pajiset me një NIPT/NUIS të ri, vetëm mbas çregjistrimit të atij ekzistues. Gjithashtu, për çdo veprimtari të re që kërkon të regjistrojë, personi fizik tregtar, do pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, për të mundësuar identifikimin e vendndodhjes të kësaj veprimtarie të re.

- Rregullimin lidhur me kalimin e tatimpaguesit në regjistrin pasiv, vetëm pas pagimit të të gjitha detyrimeve tatimore të tatimpaguesit. Ky përcaktim do të mbyllë shtegun për kalimin në regjistrin pasiv të një aktiviteti sa herë që evidentohet detyrime tatimore të papaguara duke mos lejuar shtimin e nivelit të borxhit të pambledhshëm. Çdo transaksion që do të kryhet nga tatimpaguesit e regjistruar në regjistrin pasiv do të konsiderohet si shkelje dhe do penalizohet së bashku me tatimpaguesin në regjistrin aktiv që ka kryen transaksionin me të.
- Rritjen e nivelit nga 100 (një qind) lekë në 1000 (njëmijë) lekë të shumës së detyrimit tatimor të detyrueshme për t'u paguar ose e tepricës së kredisë, që vlerësohet si detyrim ose kredi me vlerë zero, shumë kjo për cilën nuk bëhet vlerësim tatimor nga administrata tatimore.
- Përcaktimin e radhës së pagesës së kontributeve dhe të detyrimeve tatimore duke filluar me detyrimet më të hershme brenda të njëjtit lloj si dhe mundësohet lehtësimi i procedurave, përmes përdorimit të gjerë të komunikimit elektronik si dhe thjeshtësimit dhe qartësimit të procedurave të njoftimit për pagesën e detyrimeve tatimore, të pagesës.
- Ndryshimin lidhur me procedurat e deklarimit të detyrimit tatimor si të pa mbledhshëm dhe fshirjen/shuarjen e tij dhe me lehtësirat ndaj tatimpaguesit duke përjashtuar nga pagesa që duhen bërë si kusht për të ushtruar të drejtën e ankimit pranë organit tatimor, gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar dhe kamatë vonesat e llogaritura.
- Përmirësimin e kreut të sanksioneve, përmes të cilave trajtohen si deklarim i pasaktë, rastet e rivlerësim në ulje të tepricës kreditore të tatimpaguesit, në përfundim të kontrollit tatimor, duke parashikuar një penalitet në masën 20% të diferencës ndërmjet tepricës kreditore të deklaruar me tepricën kreditore që duhej deklaruar si dhe propozohen lehtësira edhe në trajtimin e kundërvajtjeve administrative duke parashikuar ulje të penaliteteve në 30%, për rastet kur tatimpaguesi pranon vlerësimin tatimor dhe e paguan detyrimin.

Gjatë diskutimeve në Komision përfaqësues të shoqatave të biznesit përshëndetën ndryshimet në këtë projektligj, që lidhen me vendosjen e rregullave më të qarta dhe sakta për zbatimin e procedurave tatimore. Megjithatë, përfaqësues të disa shoqatave i sugjeruan Komisionit

rishikimin e dispozitës që penalizon subjektet në rregjistrin aktiv për rastet kur kryejnë transaksione me subjektet e rregjstrit pasiv.

Në përfundim të mbledhjes, Komisioni e miratoi projektligjin nen për nen dhe në terësi me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

RELATOR

KRYETARI

Ervin BUSHATI

Erjon BRAÇE